

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority

Vendimi Nr.107/24

Datë: 17.12.2024

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023 Për Procedurën e Parashtrimit të Kërkesave për Lejimin e Përqendrimit dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Përkates. Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, pas shqyrtimit të Raportit të Sekretariatit, në mbledhjen e datës 17.12.2024, mori këtë;

V E N D I M

I. Të Lejohet, Përqendrimi i ndërmarrjeve lidhur me blerjen e aksioneve të platformës elektronike DoberAvto.si, (targeti) nga NLB Car&Go d.o.o. (blerës).

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55, paragrafi 1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 30.10.2024, me Nr. Prot. 710/24-11/H ka pranuar kërkesën për Përqendrim të ndërmarrjeve lidhur me blerjen e aksioneve të platformës elektronike DoberAvto.si (targeti) nga NLB Car&Go d.o.o. (blerës).

Procedurat e ndjekura:

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 22.11.2024
2. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 25.11.2024
3. Marrëveshja/Kontrata për Transferimin e Biznesit, e lidhur me datës 23 tetor 2024.

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi pjesëmarrësve në përqendrim e kalon shumë më 20,000,000 Euro në tregun ndërkombëtar dhe njëri pjesëmarrës në përqendrim ka mbi 1,000,000 Euro qarkullim në tregun e brendshëm.

2. Marrëveshja/Kontrata për Transferimin e Biznesit, e lidhur me datën 23 tetor 2024.

Pas pranimit të Njoftimit për Përqendrim, i paraqitur në bazë të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe bazuar në nenet 11,13,17,18 si dhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2023 neni 18 dhe 20 paragrafi (1.3) Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve Sekretariati ka filluar vlerësimin e kërkesës për Përqendrim.

Palët në transaksion:

Blerësi, NLB Car&Go d.o.o., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e sapo themeluar sipas ligjeve të Republikës së Sllovenisë, me seli në Lubljanë, me adresë në Slandrova ulica 2, 1231, Lubjanë-Crunce, Slloveni, e regjistruar në regjistrin tregtar Slloven me numër regjistrimi: 9773002000. Blerësi është në pronësi dhe kontroll të plotë të **NLB Lease&Go d.o.o.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Sllovenisë, me seli në Lubljanë dhe me adresë në Slandrova ulica 2, 1231, Lubjanë-Crunce, Slloveni, e regjistruar në regjistrin tregtar Slloven me numër regjistrimi: 8645868000. **NLB Lease&Go** është në pronësi dhe kontroll të plotë të **Nova Ljubljanska banka d.d.**, shoqëri aksionare e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Sllovenisë, me seli të regjistruar në Trg. Republike 2, 1000 Lubljanë, Slloveni, e regjistruar në regjistrin tregtar Slloven me numër regjistrimi: 5860571000.

Në tregun e Kosovës, **NLB d.d.**, është e pranishme përmes degës së saj: **NLB Banka SH.A.**, shoqëri aksionare, e themeluar në përputhje me ligjet e Kosovës, me seli të regjistruar në Rr. "Ukshin Hoti", nr. 124, e regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë ("**ARBK**") me numër unik të identifikimit 810486250, e cila operon si bankë komerciale në përputhje me licencën e lëshuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

Targeti, DoberAvto.si, është platformë elektronike për blerjen dhe shitjen e veturave të përdorura. Platforma elektronike është aset i dhe në pronësi të plotë të **AMZS družba za opravljanje storitev na področju mobilnosti d.o.o.**, shoqëri me përgjegjësi të limituar, e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Sllovenisë, me seli në Lubljanë, dhe me adresë në Dunajska cesta 128 A, 1000 Lubljanë, Slloveni e regjistruar në regjistrin tregtar Slloven me numër regjistrimi: 5488338000. Targeti nuk është njësi e veçantë juridike, por aset i AMZS. AMZS është ofruesi kryesor i shërbimeve për Shoqatën e Automobilitave në Slloveni. AMZS bashkon 104 klube automobilistike dhe klube turistike automobilistike në Slloveni, me mbi 90,000 anëtarë. AMZS gjithashtu ofron asistencë për anëtarët e saj në bashkëpunim me klubet e tjera automobilistike evropiane. AMZS është anëtare e shoqatave ndërkombëtare të automobilitave dhe motoçikletave FIA, AIT, FIM, UEM, Alpe Adria Motorcycle Union dhe ARC Europe.

Tregu përkatës;

Tregu i produktit: Platformë elektronike për blerjen dhe shitjen e veturave të përdorura.

Tregu gjeografik:, tregu përkatës gjeografik përkufizohet *territori i Republikës së Sllovenisë*.

Analiza e konkurrencës:

Transaksioni i propozuar nuk paraqet shqetësim për çështje të konkurrencës në tregun e Republikës së Kosovës, pasi që, nuk ka mbivendosje të produkteve mes shoqërive të përfshira në transaksion në tregun gjeografik të Kosovës. Sa i përket filialit të Nova Ljubljanska banka d.d., pra NLB Banka SH.A, dega në Kosovë e cila operon si bankë komerciale në përputhje me ligjet e Kosovës, duke ofruar shërbime për klient si, llogaritë bankare, kreditë, pagesa vendore dhe ndërkombëtare, kartela bankare, garancione bankare, letër kredi dhe e-banking etj, ndërsa sa i përket aktivitetit ku palët në transaksion operojnë, pra platformë elektronike për blerjen dhe shitjen e veturave të përdorura blerësi dhe as targeti nuk ofrojnë këto shërbime për klientët në Kosovë.

NLB Banka Sh.A., ka një strukturë tregu përafërsisht nga 17-20%, mirëpo, duke parë që Aplikuesi dhe targeti nuk ka shtrirje të aktiviteteve në Kosovë dhe as nuk planifikon të ketë as të ardhmen pasi që aktivitetin e saj do ta shtrijë në vendin ku tashmë janë prezent. Blerësi synon që pas realizimit të transaksionit të fuqizoj dhe shtrijë aktivitetin e saj duke ofruar shërbime edhe me të sofistikuara për klientët në tregun e Republikës së Sllovenisë, ndërsa sa i përket tregut të Republikës së Kosovës ndërmarrja e ndërlidhur me blerësi e cila vepron në Kosovë do të ruaj pozicionin aktual të tregut, që do të thotë se kushtet e konkurrencës do të mbesin të njëjta si para transaksionit

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Duke pasur parasysh se blerësi dhe targeti nuk janë aktiv në tregun e Republikës së Kosovës të, pra nuk ofrojnë shërbime të platformës elektronike për blerjen dhe shitjen e veturave të përdorura të pra mes tyre nuk ka mbivendosje të aktiviteteve të palëve në Kosovë në tregun përkatës. Sipas vlerësimit të përqendrimit nga ky transaksion, nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën në Republikën e Kosovës. Andaj, Transaksioni i propozuar nuk do të ndikoj në tregun e Republikës së Kosovës dhe si i tillë nuk ngrit shqetësimin për konkurrencën dhe as konsumatorët në Republikën e Kosovës, pra nuk do të kufizoj apo do të shtrembëroj konkurrencën në tregun përkatës dhe tregu i Kosovës mbetet i pandikuar nga ky transaksion.

Autoriteti ka vlerësuar se ky transaksion/blerja nuk ndikon në forcimin e pozitës dominuese të ndërmarrjes blerëse tek operatorët ekonomik apo konsumatorët.

Autoriteti, me marrjen e njoftimit të plotë të përqendrimit, në përputhje me nenin 17 paragrafi 3 në paragrafi 3.4, ka publikuar në ueb faqen e vet njoftimin publik, për përqendrimin e synuar, i cili është obliguar të qëndroj 15 ditë, (<https://ak.rks-gov.net>), lidhur me parashtrimin e vërejtjeve, komenteve, në mënyrë që të dhënat e mbledhura të kontribuojnë në sqarimin, pra në kuptim, të marrëdhënies dhe situatës në tregjet përkatëse. Autoriteti, nuk ka pranuar asnjë reagim, nga palët e interesuara.

Shënim:


Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti – konkurruese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përçendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI**

Neime Binaku-Isufi
Kryetare



Kaltrina Sela
Nënkryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare

Florent Mehmeti
Anëtar

Salihe Gashi Loku
Anëtare

III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva